



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:116453  
Datë: 09.09.2024  
Numri i dokumentit: 06134856

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.57/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në Objektin e Gjykatës në veri-Mitrovicë), Kryetari i Trupit Gjykues Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Edita Kelmendi-Rexhepi, në çështjen penale kundër të pandehurit V.D i akuzuar për veprën penale, Konflikti i interesit sipas neni 417 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr.45/2024 dt.25.06.2024. Në këtë çështje shqyrtimi fillestar është mbajtur në prezencën e palëve, prokurorit të shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehurit V.D dhe mbrojtësit të tij av.Diar Jusufi. Pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më dt.05.09.2024, Gjykata të njëjtën ditë ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa më datën 09.09.2024 e ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

V.D nga i ati ....., e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në M....., Rr “.....” –afër ....., i martuar, baba i një fëmije, punon në spitali “Dr.....” në M....., në pozitën administrator në sistemin informativ shëndetësor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ID;....., i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar me parë dhe nuk zhvillohen procedura tjera për vepra tjetër penale, i njëjti;

SHPALLET FAJTOR

Sepse:

Gjatë muajit korrik 2023, në Spitalin e Përgjithshëm “Dr.....” në M..... në cilësinë e personit zyrtar – anëtarit të Komisionit Vlerësues sipas Vendimit Nr..... të datës 20.06.2023, ka marrë pjesë personalisht në çështje zyrtare për të cilën e ka ditur se ka qenë në konflikt të interesit dhe atë me rastin e vlerësimit të testit me shkrim për kandidaten S.D me Kodin ....., në shpalljen përfundimtare të rezultateve të testit me shkrim Nr..... të

datës 06.07.2023, në vlerësimin individual të datës 15.07.2023 të intervistimit me gojë si dhe në rasti e nxjerrjes së vendimit Nr..... të datës 19.07.2023 për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën infermier i/e përgjithshëm/me, ku në mesin e kandidatëve është përzgjedh edhe kandidatja S.D me Kodin ..... me të cilën i pandehuri është në lidhje familjare konkretisht e ka teze apo motër të nënës.

-Me këtë ka kryer veprën penale; Konflikti i interesit sipas nenit 417 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 43, 46, 48, 49, 69, e lidhur me nenet 365 dhe 366 të KPP-së, të pandehurit, i;

#### SHQIPTON

- DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej dy (2) vite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër penale të natyrës së njëjtë apo të rëndë, DHE
- DËNIM ME GJOBË në shumë prej 2,000 (dymijë) euro, të cilin dënim-gjobë obligohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke ia përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë.
- I pandehuri V.D obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumën prej 50 euro në emër të taksës në Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 70 (shtatëdhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Kërkesë pasurore-juridike nuk kishte.

## Arsye t i m

### Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.45/2024 dt.25.06.2024, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ndaj të pandehurit V.D për veprës penale; Konflikti i interesi nga neni 417 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

### - Rrjedha e procedurës penale:

Me datën 05.09.2024 për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve, prokurores së shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Fetije Bajrami, të pandehuri V.D dhe mbrojtësit të tij av.Diar Jusufi.

I pandehuri V.D në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 05 shtator 2024 pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij për në këtë fazë të procedurës penale, dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurorja Fetije Bajrami dhe mbrojtësi i të pandehurit, av.Diar Jusufi, kanë propozuar që të miratohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri, duke vlerësuar janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë siç përcaktohet me nenin 242 të KPP-ës.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri V.D dhe në mbështetje të nenit 242 par.6 të KPP-ës, ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për miratimin e pranimi të fajësisë. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë siç janë: Konkursin Nr.Prot:..... të datës 25.04.2023 i shpallur nga Spitali i Përgjithshëm “Dr.....” në M....., Vendimin Nr..... të datës 20.06.2023 për formimin e Komisionit, Listën me Nr..... të datës 16.06.2023 lidhur me kandidatët që i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit, Vlerësimin e testit me shkrim për kandidaten S.D me Kodin ....., Shpalljen e rezultateve të testit me shkrim me Nr..... të datës 06.07.2023, Vlerësimin individual të testimit të bërë nga i pandehuri V.D për kandidaten S.D i datës 15.07.2023, Vendimin Nr..... të datës 19.07.2023 për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitën infermier/e i/e përgjithshëm/me, Vendimin Nr..... të datës 04.08.2023 për themelimin e

marrëdhënies së punës për S.D, Kontratën e Punës me Nr..... të datës 04.08.2023 e lidhur në mes Spitali i Përgjithshëm “Dr.....” në Mitrovicë dhe S.D, Përgjigja Nr.02-341 - Nr.Ref:..... e datës 12.03.2024 të Agjencisë së Regjistrimit Civil, Vendimin me Nr..... të datës 22.03.2024 nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Vendimin Nr..... i datës 02.08.2023 për caktimin e V.D në vendin e punës dhe detyrat e punës Zëvendës Zyrtar i Prokurimit në Spitalin e Përgjithshëm – M..... dhe Kontratën e Punës me Nr..... të datës 02.08.2023 e lidhur në mes Spitali i Përgjithshëm “Dr.....” në M..... dhe V.D si dhe Vendimin Nr..... të datës 22.04.2024, vendimi mbi ndërperjën e mardhënies së punës kandidatës S.D me nr të protokollit: ..... dt.22.04.2024 si dhe vendimi me nr të protokollit: ..... dt.03.09.2024 me të cilën i pandehuri është caktuar në pozitën administrator në sistemin informativ shëndetësor. Bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe dëshmitë si më lart dëshmojnë përtej çdo dyshimi se i pandehuri ka kryer veprën penale; Konflikti i interesit sipas nenit 417 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare pasi që e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Të pandehurit i është tërhequr vërejtjen se pas pranimit të fajësisë nuk mund ta shfrytëzojnë të drejtën në ankesë lidhur me konstatimin e gabuar të gjendjes faktike, gjithashtu është njoftuar se nëse e pranon fajësinë e humb mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Prandaj duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lart, përtej çdo dyshimit është vërtetuar se i pandehuri V.D është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata për të pandehurin V.D, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit sipas nenit 69 të KPRK-ës, si rrethanë rënduese ka vlerësuar, shkallën e lartë të dashjes te kjo veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë rast, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, humbjen e besimit të publikut te institucionet publike, pastaj, motivin e veprës penale dhe qëllimin e përfitimit për familjarin e tij.

Gjykata i ka vlerësuar edhe rrethana lehtësuese për të pandehurin, si, sjelljen e mira të tij, para dhe pas këtij rasti, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, nuk zhvillohet asnjë rast tjetër penale, se i pandehuri ka shprehur keqardhje dhe pendimin e thellë për rastin, është i moshës së re, prind i një fëmije të mitur, mbajtës i vetëm i familjes. Për më tepër, pasojat e veprës penale janë mënjeluar ngase Spitali i Përgjithshëm “Dr.....” në M....., sipas vendimit me numer të protokollit: ..... i dt.22.04.2024 ia ka ndërprerë mardhënien e punës të punësuarës S.D. Gjithashtu Spitali i Përgjithshëm në M....., ndaj të pandehurit ka marr masat përkatëse duke e ulur në pozitën e punës, i cili më nuk ushtron pozitën e njëjtë të punës në të cilën ka shërbyer deri në këtë rast. Ndërsa, si rrethanë tjetër lehtësuese për të pandehur është marr për bazë pranimi i plotë dhe pakushte i fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe në këtë mënyrë ka kontribuar në zgjidhjen e shpejtë, plotë dhe efikase të kësaj çështje penale. Kjo rrethanë dhe rrethanat e cekura si më lart, kanë qenë vendimtare që Gjykata të vendos që dënimin me burgim të shqiptuar ndaj të pandehurit ta kushtëzoj të mos ekzekutohet. Gjithashtu, duke pasur parasysh faktin se pasojat e veprës penale janë mënjeluar, se i pandehuri është mbajtës i familjes dhe nga të ardhurat nga ky vend i punës e mban familjen e tij, faktin se i pandehuri është ulur në pozitë dhe mundësia me përsërit veprën penale më nuk ekziston, duke qenë se ka shërbyer veten njëherë si anëtar i komisionit përkatës dhe pjesëmarrjen në këtë komision për rekrutim nuk bënë pjesë të detyrat e rregullta në punën e tij. Prandaj nga arsyet e cekura më lart, Gjykata nuk i ka shqiptuar të pandehurit dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike.

Gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të pandehurit V.D, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat e

tjera që i kemi cekur më lartë është adekuat dhe jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat e tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Sa i përket dënimit me gjobë, përveç rrethanave të cekura Gjykata ka marr për bazë edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e mori vendimin në bazë të nenit 449 të KPP-ës.

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.57/2024 të datës 09.09.2024

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi-Rexhepi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, llogaritur nga dita e pranimit me shkrim të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për palët gjykatën.